



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Integrimit Evropian/Ministarstvo za Evropske Integracije*  
*Ministry of European Integration*

---

Numri i kontratës: MIE-\_\_\_/\_\_\_-

Ministria e Integrimit Evropian duke u bazuar në Nenin 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90, 01 dhjetor 2010), lidh:

**KONTRATË PËR VIJIMIN E PRAKTIKËS**

**NENI 1**  
**PALET KONTRAKTUESE**

Me anë të kësaj kontrate, Ministria e Integrimit Evropian, Nënë Tereza, p/n, 10000 Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga Z. Demush Shasha (punëdhënësi), lidh Kontratë për vijimin e Praktikës me Z/Znj. \_\_\_\_\_ i lindur në \_\_\_\_\_ me \_\_\_\_\_ me nr. personal \_\_\_\_\_ (në vijim praktikanti).

**NENI 2**  
**DETYRAT E PRAKTIKANTIT**

Praktikanti kryen detyrat e përcaktuara që janë të dedikuara për vijimin e praktikës. Detyrat e praktikantit përcaktohen nga Udhëheqësi i sektorit përkatës. (Varësisht se në cilin Departament bëhet sistemimi – përcaktohen detyrat në të cilat praktikanti mund të kyçet).

**NENI 3**  
**PERIUDHA E PRAKTIKËS DHE ORARI I PUNËS**

Ky nen plotësohet varësisht nga Marrëveshja në mes të punëdhënësit dhe praktikantit. (“Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj” – ky formulim derivon nga Neni 16 i Ligjit i Punës).

**NENI 4**

1. Puna e praktikantit gjatë vijimit të praktikës është pa kompensim të pagës.
2. Punëdhënësi e regjistron praktikantin në listën e evidencave pa kompensim të pagës.

**NENI 5**  
**RUAJTJA E SEKRETIT**

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe pas skadimit të saj, \_\_\_\_\_ nuk i lejohej që t'i zbulojë informatat konfidenciale lidhur me shërbimet, këtë kontratë, apo veprimtarinë e porositesit pa miratimin me shkrim nga ana e MIE-së.

**NENI 6**  
**MIRËSJELLJA**

Praktikanti i nënshtrohet dhe duhet t'i përmbahet përshtatshërisht dispozitave të Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil Nr. 01/2006 dhe Kodit të Sjelljes në MIE.

**NENI 7**  
**STANDARDI I PUNËS**

1. Praktikanti obligohet t'i kryejë shërbimet sipas standardeve më të larta të etikës profesionale.
2. Praktikanti obligohet t'i ruajë dhe përdorë me kujdes të gjitha pajisjet me të cilat ngarkohet dhe në pajtim me obligimet e marra.

**Nënshkrimi**

Unë i kuptoj dhe pajtohem t'iu nënshtrohem kushteve dhe rrethanave në këtë kontratë.

Nënshkruar nga punëdhënësi:

Emri: Demush Shasha

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

Nënshkruar nga praktikanti

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_